

Aktiviteti: Panairi i Punës

Data: 05.06.2018

Vendi: Korpusi Qendror UPT

Ora: 10.00

Objektivat :

- Të ndihmojë në një përjasje më të mirë të studentëve ndaj tregut të punës.
- Të njihen studentët me kompanitë e punës pranë të cilave mund të kryejnë praktika profesionale e pse jo dhe të aplikojnë për punë
- T'u ofrojë studentëve mundësi punësimi pas diplomimit si dhe internshipi gjatë programeve të studimit.
- T'u japë mundësi të gjithë kompanive, rekrutuesve dhe institucioneve pjesëmarrëse të ekspozojnë ofertat e tyre për studentët dhe pjesëmarrësit e tjerë të këtij eventi.
- Të lidhen marrëveshje bashkëpunimi mes kompanive dhe Universitetit Politeknik të Tiranës.

Kompanitë pjesëmarrëse: FORSCHNER Albania; Everest sh.p.k, VIBTIS, TCN Shpk, Weweb shpk, Bankers Petroleum Ltd. Albania, A.L.T.E.A., Geostudio 2000, Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te paluajtshme, "Gjeo-Vjosa" SHPK, HE-SK sh.p.k, Kontakt Shpk, Albtelecom, Fabrika e Cimentos Fushe-Kruje, Vodafone, Agikons, Gener 2, Shega Trans, Megatek sa, ABCom, Intracom, Mane TCI, Mito-2, Blue Sky, Bashkia Tirane, ikubINFO ltd, BKT, ITE Group , Dua Punë, Deloitte Albania, Telecom, TAP, HYGEIA

Studentët pjesëmarrës : Studentë të 7-të fakulteteve të Universitetit Politeknik të Tiranës , kryesisht në nivelin Bachelor dhe Master.

Në datën 5 Qershor 2018 ora 10.00 në ambientet e Korpusit Qendror të UPT-së, Universiteti Politeknik i Tiranës organizoi për herë të parë PANAIRIN E PUNËS, urë lidhëse midis Tregut të Punës dhe Studentëve.

Ky panair shërbeu për të forcuar lidhjen e universitetit me tregun e punës i cili do të japë përfitime të dyfishta si për studentët dhe për kompanitë. Studentët patën mundësi të njihen me kompanitë e punës pranë të cilave mund të kryejnë praktika profesionale e pse jo dhe të aplikojnë për punë. Ndërsa, kompanitë u njohën nga afër me studentët dhe më pas do të kenë mundësi të vlerësojnë potencialet e atyre që mund të rekrutohen nesër si punonjës pranë tyre.

Secila nga kompanitë që mori pjesë në panair kishte në dispozicion nje tendë për të paraqitur materiale informuese në lidhje me profilet e kompanive të tyre për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, të cilët ishin të interesuar për mundësi për praktika mësimore, për angazhime në projekte të ndryshme, për internship si dhe për mundësi punësimi në varësi të organizimit aktual të burimeve njerëzore në strukturën e tyre.

Edhe Universiteti Politeknik i Tiranës kishte një tendë ku ekspozoi punë konkrete të realizuara nga studentët, grupet kërkimore-shkencore apo stafi akademik. Kjo shërbeu për të treguar dhe ekspozuar produkte të universitetit tonë.

Bashkëlidhur gjithë materialet

<http://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/804-panairi-i-punes-5-qershor-2018>

